ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

PORTA E STUDENTIT



Hulumtim për shpenzimet e studentëve të Universitetit të Prishtinës

SHPORTA E STUDENTIT

Hulumtim për
shpenzimet e studentëve të
Universitetit të Prishtinës

Publikues:

ORCA – Organizata për rritjen e cilësisë në arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Autorë:

Adea Kondirolli

Dibran Hoxha

Prishtinë, qershor 2019

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	5
Metodologjia	6
Të dhënat e përgjithshme	7
Fakulteti Ekonomik	15
Fakulteti Juridik	18
Fakulteti i Edukimit	21
Fakulteti Filozofik	23
Fakulteti i Mjekësisë	25
Fakulteti i Arteve	28
Fakulteti i Filologjisë	30
Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore	32
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	34
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	37
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	39
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	41
Fakulteti i Shkencave Sportive	43
Përfundime	45

HYRJE

70,313 studentë janë pjesë sistemit universitar publi në Kosovë, sipas Agjencisë s Statistikave të Kosovës.[1] Këta studentë në masë të madhe nu marrin pjesë në tregun e punës 55.4% e njerëzve të moshës 15-24 vjeç janë të papunë.[2]

Kosova ka pagesën më të ulët për semestër në rajon, me 25 euro për semestër ose 50 Euro në vit (përjashto: studentët e vitit të parë, kategoritë e dala nga lufta, familjet me asistencë sociale, dhe ata me dy ose më shumë studentë të liruar nga pagesa). Studentët në Kroaci paguajnë 270-1300 euro në vit (varet nga fusha e studimeve)[3]; ata në Serbi paguajnë 1000-5000 euro në vit[4]; studentët në Maqedoninë e Veriut paguajnë 200-400 euro në vit[5]; dhe studentët në Shqipëri paguajnë 160-330 euro në vit.[6]

Universitetet publike të Kosovës ndërkohë rangohen shumë ulët në lista botërore, megjithatë Universiteti i Prishtinës është universiteti më së miri i ranguar mes universiteteve shqipfolëse të rajonit të Ballkanit.

Pavarësisht çmimit të ulët të pagesës së semestrit, familjet kosovare kanë vështirësi në shkollimin universitar të fëmijëve të tyre. Paga mesatare në Kosovë për vitin 2017 është 471 euro neto.

Prandaj, ORCA ka vendosur të hulumtojë sa shpenzon një student në Universitetin e Prishtinës, në mënyrë që të kuptojmë natyrën e shpenzimeve, dhe çka mund t'i ofrojnë institucionet këtyre studentëve.

Në këtë hulumtim janë përfshirë 176 studentë në fokus grupe të ndara (si dhe në pyetësorë anonim) të cilët janë përgjigjur për të gjitha llojet e shpenzimeve të tyre gjatë studimeve. Mesatarisht një student shpenzon 150 euro në muaj, me minimumin 25 dhe maksimumin 400. Por, këto shpenzime dallojnë sipas kategorive që i përkasin studentët, si dhe vitet e studimit.

Studentët që udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre drejt Prishtinës shpenzojnë mesatarisht 129.31 euro në muaj.

Studentët që janë banorë të përhershëm të Prishtinës dhe jetojnë me familjet e tyre shpenzojnë mesatarisht 139.26 euro në muaj.

Studentët që banojnë në konviktet e Qendrës së Studentëve shpenzojnë mesatarisht 140.22 euro në muaj.

Studentët që banojnë me qira në Prishtinë përgjatë studimeve të tyre shpenzojnë mesatarisht 220.23 euro në muaj.

1. http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf
2. http://ask.rks-gov.net/media/4671/anketa-e-tregut-te-punes-2018.pdf
3. https://ec.europa.eu/education/study-in-europe/country-profiles/croatia_en
4. https://ec.europa.eu/education/study-in-europe/country-profiles/serbia_en
5. https://ec.europa.eu/education/study-in-europe/country-profiles/fyr-macedonia_en
6. https://arsimi.gov.al/ëp-content/uploads/2018/07/Tabela_finale_kuota_tarifa.pdf

METODOLOGJIA

ORCA ka organizuar 13 fokus grupe me studentë nga 13 njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës. Në këto 13 fokus grupe kanë marrë pjesë gjithsej 176 studentë, nga të cilët 111 janë fem-ra, dhe 65 janë meshkuj.

Studentët janë përzgjedhur në bazë të viteve të studimit, si dhe kategorive që i përkasin (banojnë me qira në Prishtinë, udhëtojnë çdo ditë, banojnë në konvikte, si dhe banorë të përhershëm të Prishtinës).

52 studentë janë në vitin e parë, 56 janë në vitin e dytë, 50 në vitin e tretë, 12 në vitin e katërt, katër në vitin e pestë, dhe dy në vitin e gjashtë.

43 studentë banojnë me qira në Prishtinë, 43 udhëtojnë çdo ditë, 47 banojnë në konvikte, dhe 43 janë banorë të përhershëm të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve në fokus grupe është 20.

Në fokus grupe, studentët kanë plotësuar fillimisht një pyetësor me 13 pyetje rreth shpenzimeve të tyre në studime, duke u përgjigjur vetëm me shuma. Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve pastaj janë shtjelluar në një diskutim të përbashkët, ku studentët kanë shtuar edhe informata të tjera rreth secilit shpenzim dhe problem që hasin në studimet e tyre.

Pyetësorët janë plotësuar konfidencialisht, pa informata identifikuese, dhe janë mbledhur në një zarf për secilën njësi akademike. Të dhënat nga pyetësorët janë përpunuar me analiza statistikore dhe janë plotësuar me informata dhe detaje nga diskutimi në fokus grup.

Fokus grupet janë mbajtur me secilën njësi akademike brenda 28 shkurtit dhe 2 majit, 2019. Transkriptimet e audio regjistrimeve dhe shënimet e marra nga diskutimet në fokus grupe, janë shtuar në këtë hulumtim.

Të dhënat janë të paraqitura në mënyrë tabelare për secilën njësi akademike, dhe informatat nga diskutimet janë paraqitur në mënyrë narrative.

Të dhënat e përgjithshme

ORCA ka organizuar 13 fokus grupe me studentë nga 13 njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës. Në këto 13 fokus grupe kanë marrë pjesë gjithsej 176 studentë, nga të cilët 111 janë femra, dhe 65 janë meshkuj.

52 studentë janë në vitin e parë, 56 janë në vitin e dytë, 50 në vitin e tretë, 12 në vitin e katërt, katër në vitin e pestë, dhe dy në vitin e gjashtë.

43 studentë banojnë me qira, 43 udhëtojnë çdo ditë, 47 banojnë në konvikte, dhe 43 janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve në fokus grupe është 20.

PAGESA E SEMESTRIT

Studentët e Universitetit të Prishtinës paguajnë 25 euro për semestër që nënkupton 50 Euro në vit.[7] Viti i parë në Universitetin e Prishtinës është i liruar nga pagesa, përpos për studentët me shtetësi të huaj. Kategori tjera që lirohen nga pagesa janë: familjarë të dëshmorëve, të zhdukurve dhe invalidëve të luftës, familjarë të veteranëve të luftës, familjarë të viktimave civile të luftës, studentët me nevoja të veçanta, familjet me asistencë sociale, si dhe familjet që kanë dy ose më shumë studentë në Universitetin e Prishtinës paguajnë vetëm për njërin.

Pagesa e semestrit		
Vitet e studimit	**Paguajnë**	**Nuk paguajnë**
Viti i parë	4	48
Viti i dytë	53	3
Viti i tretë	43	7
Viti i katërt	12	0
Viti i pestë	4	0
Viti i gjashtë	1	1

Tabela 1. *Numri i studentëve që paguajnë semestrin, sipas viteve të studimit.*

7. Në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, programi i Arkitekturës është me studime të integruara (bachelor+master), dy vitet e fundit që përkojnë me studimet master, paguhen 150 euro për semestër.

SHPENZIMET PËR LITERATURË

Studentët shpenzojnë mesatarisht 37.7 euro për semestër në literaturë të nevojshme për studime. Maksimumi i raportuar arrin 150 euro, ndërsa minimumi 5 euro. Studentët kanë raportuar shumë probleme rreth literaturës së përdorur gjatë studimeve, si: literaturë joadekuate për programin ose të papërditësuar, detyrime nga profesorët për të blerë librat e tyre, shitja e kopjeve jo të autorizuara nga autorët e librave, libra të papërkthyer ose të përkthyer me gabime, etj.

Shpenzimet për literaturë për semestër sipas viteve të studimeve	
Vitet e studimit	**Mesatarja në euro**
Viti i parë	38.5
Viti i dytë	35.5
Viti i tretë	34.8
Viti i katërt	42.9
Viti i pestë (Mjekësi)	61.25
Viti i gjashtë (Mjekësi)	70

Tabela 2. *Shpenzimet për literaturë për një semestër, sipas viteve të studimeve*

Shpenzimet për literaturë për semestër sipas fakulteteve	
Fakultetet	**Mesatarja në euro**
Fakulteti Ekonomik	22.34
Fakulteti Juridik	43.9
Fakulteti i Edukimit	24.3
Fakulteti Filozofik	24.46
Fakulteti i Mjekësisë	87.9
Fakulteti i Arteve	45.57
Fakulteti i Filologjisë	36.08
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	32.08
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	49.6
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	25.3
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	35.2
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	25.7
Fakulteti i Shkencave Sportive	19.07

Tabela 3*. Shpenzimet për literaturë për një semestër, sipas fakulteteve*

MATERIALE SHPENZUESE

Përveç literaturës së nevojshme për studime, studentët gjithashtu kanë shpenzime të materialeve të tjera të nevojshme për studime. Këto shpenzime variojnë nga fakulteti në fakultet. Materialet shpenzuese përfshijnë: hamerat, çantat speciale, stilolapsa special për fakultetet teknike; manteli i bardhë, doreza, kapuçat dhe maskat, bretkosat për Fakultetin e Mjekësisë; pajisjet për sporte të ndryshme në Fakultetin e Shkencave Sportive; telat e instrumenteve, akordimi i tyre, instrumentet, panelet dhe ngjyrat për pikturë, materialet tjera për Fakultetin e Arteve, etj.

Materiale shpenzuese për semestër sipas fakulteteve	
Fakultetet	**Mesatarja**
Fakulteti Ekonomik	10.68
Fakulteti Juridik	49.28
Fakulteti i Edukimit	11.90
Fakulteti Filozofik	17.5
Fakulteti i Mjekësisë	47.22
Fakulteti i Arteve	133.21
Fakulteti i Filologjisë	19.25
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	22
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	122.15
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	45.25
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	52.27
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	51.65
Fakulteti i Shkencave Sportive	105

***Tabela 4**. Materialet shpenzuese për një semestër, sipas fakulteteve*

PAGESA TË TJERA ADMINISTRATIVE

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj. Transkripta e notave është 2.5 euro, dhe nevojitet për praktika, bursa, shkëmbime, etj. Pjesëmarrësit në fokus grupe kanë pohuar që këto shërbime do duhej të përfshiheshin në pagesën për semestër dhe të ofroheshin falas.

SHPENZIME TË UDHËTIMIT

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të përhershëm Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve.

Shpenzimet e udhëtimit për aq sa lidhen me afërsinë ndërmjet lokacioneve prej nga udhëtohet për në fakultet nuk përbën problem, marrë parasysh edhe lehtësimet për studentë në bileta të udhëtimit.

Shpenzimet javore të udhëtimit	
Kategoritë	**Mesatarja**
Studentët që banojnë me qira në Prishtinë	7.53
Studentët që udhëtojnë çdo ditë për në Prishtinë	13
Studentët që banojnë në konvikte	8.54
Studentët banorë të përhershëm të Prishtinës	6.1

Tabela 5. *Shpenzimet javore të udhëtimit, sipas kategorive që i përkasin studentët*

SHPENZIME TË USHQIMIT

Sa i përket ushqimit, 47 studentë ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake. Sipas studentëve, mensa nuk e mbulon ditën e diele dhe orari i servimit të ushqimit nganjëherë mund të interferojë me orarin e ligjëratave, gjithashtu për fakultetet që janë larg Qendrës së Studentëve, nuk kanë kohë të ushqehen në mensë për shkak të orarit të ligjëratave.

Cilësia e ushqimit në mensë ishte temë diskutimi mes studentëve që ushqehen ose janë ushqyer aty. Disa thonë që në krahasim me pagesën, cilësia është shumë e mirë; të tjerët thonë që cilësia e ushqimit është shumë e dobët dhe që ushqimi nuk ka shumë varietet.

Studentët e tjerë që ushqehen në mënyrë vetanake preferojnë ushqimin e gatshëm në krahasim me gatimin në banesë. Shpenzimet e ushqimit në mënyrë vetanake sillen nga 0.5 deri 20 euro në ditë, ku përgjigjja më e shpeshtë ishte që shpenzojnë 5 euro në ditë.

SHPENZIMET E BANIMIT

47 studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj.

Studentët e akomoduar në konvikt kanë pasur ankesat e tyre rreth kushteve të akomodimit, të tilla si qasje e kufizuar në ujë, infrastruktura e brendshme etj. Gjithashtu, konviktet më të vjetra u raportuan që janë në gjendje shumë të keqe, ndërsa konviktet e reja ishin të kënaqshme sipas respondentëve.

43 studentë banojnë me qira. Mesatarja e pagesës së qirasë dhe shpenzimeve tjera (rrymë, ujë, internet) është 84, ku maksimumi raportohet 215 dhe minimumi 30. Përgjigjja më e shpeshtë është 80 euro në muaj. Studentët ndajnë hapësirën e banimit me studentë të tjerë, shpesh familjarë, për të zvogëluar shpenzimet në këtë kategori.

SHPENZIMET E REKREACIONIT

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion. Shpenzimet më të shpeshta në këtë kategori janë kafe, cigare, shëtitje, ushqim, evente rinore, piknik, kinema, video lojëra, jeta e natës, aktivitete sportive, shopping, fitness, koncerte, teatër, hiking, udhëtime.

Shpenzimet javore të rekreacionit	
Kategoritë	**Mesatarja**
Studentët që banojnë me qira në Prishtinë	20.44
Studentët që udhëtojnë çdo ditë për në Prishtinë	13.38
Studentët që banojnë në Konvikte	14.67
Studentët banorë të përhershëm të Prishtinës	20.78

Tabela 6. *Shpenzimet javore të rekreacionit, sipas kategorive që i përkasin studentët*

Shpenzimet javore të rekreacionit	
Mesatarja	17.24
Maksimumi	100
Minimumi	2
Mediana	14
Përgjigja më e shpeshtë	10

Tabela 7. *Shpenzimet javore të rekreacionit*

SHPENZIMET TOTALE MUJORE

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Këto shpenzime variojnë nga 25 në 400 euro, ku përgjigjja më e shpeshtë është 150 euro. Shpenzimet po ashtu dallojnë sipas kategorive që i përkasin studentët, si dhe viteve të studimit.

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive	
Kategoritë	**Mesatarja**
Studentët që banojnë me qira në Prishtinë	220.23
Studentët që udhëtojnë çdo ditë për në Prishtinë	129.31
Studentët që banojnë në Konvikte	140.22
Studentët banorë të përhershëm të Prishtinës	139.26

Tabela 8. *Shpenzimet totale mujore, sipas kategorive që i përkasin studentët*

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit	
Vitet e studimit	**Mesatarja**
Viti i parë	145.7
Viti i dytë	152.84
Viti i tretë	163.65
Viti i katërt	164.17
Viti i pestë (Mjekësi)	213.75
Viti i gjashtë (Mjekësi)	262.5

Tabela 9. *Shpenzimet totale mujore, sipas viteve të studimit*

BURIMI I TË ARDHURAVE

Shpenzimet e studimeve kryesisht mbulohen nga familja. Tetë studentë nga 176 kanë raportuar që i mbulojnë shpenzimet e tyre në total vet, ndërsa 22 studentë të tjerë kanë raportuar që edhe pse punojnë, ose kanë bursë, familja duhet t'i mbulojë një pjesë të shpenzimeve të tyre.

Një pjesë e studentëve kanë raportuar që është e pamundur të punojnë (sidomos me orar të plotë) gjatë studimeve, për shkak të vijueshmërisë së ligjëratave.

Rroga mesatare e studentëve që punojnë është 168 euro, ku maksimumi arrin 380 euro dhe minimumi 30 euro. Përgjigjja më e shpeshtë është 100 euro. Studentët që punojnë shpenzojnë mesatarisht 86.22% të rrogës së tyre në muaj.

Mesatarja e të ardhurave të familjes të një studenti është 933 euro në muaj, ku maksimumi arrin 10,000[8] dhe minimumi 110 euro në muaj. Përgjigjja më e shpeshtë është 1000 euro.

Studentët shpenzojnë mesatarisht 20% të të ardhurave të familjes për studimet e tyre, në muaj.

8. Kjo e dhënë nuk është e përfshirë në llogaritje të mesatareve për shkak që devijon shumë nga të dhënat tjera (të ardhurat mesatare të familjes të tjera maksimum janë 2500 dhe 3000). Po ashtu, studenti në fjalë i mbulon shpenzimet e veta, pa ndihmën e familjes.

Fakulteti Ekonomik

Në fokus grupin e Fakultetit Ekonomik kanë marrë pjesë 11 studentë, 8 nga të cilët janë femra, dhe 3 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, katër në vitin e dytë, dhe tre në vitin e tretë. Tre studentë banojnë me qira në Prishtinë, tre studentë udhëtojnë çdo ditë për në Prishtinë, dy banojnë në konvikte, dhe tre janë banorë të përhershëm të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të Fakultetit Ekonomik është 19 (viti i parë 18, viti i dytë 19.25, dhe viti i tretë 20.3).

Përveç studentëve të vitit të parë që janë të liruar nga pagesa e semestrit, të gjithë studentët e tjerë paguajnë 25 euro për semestër. Studentët e Fakulteti Ekonomik kanë konsideruar se pagesa për semestër paraqet shumë simbolike të shpenzimeve përgjatë studimeve.

Studentët e Fakultetit Ekonomik shpenzojnë rreth 22.36 euro për semestër për literaturë. Te shpenzimet për literaturë studentët e këtij fakulteti kanë theksuar disa parregullsi që lidhen me këtë lloj shpenzimi si: profesorë të cilët kërkojnë librin origjinal; blerja e librit të profesorit në kabinetin e tij brenda hapësirave të fakultetit; profesorë të cilët favorizojnë studentët që janë të pajisur me librin e tyre dhe kërcënimi për paditje nëse hasin në studentë të cilët kanë kopjuar librin e tyre.

Studentët e këtij fakulteti gjithashtu ngarkohen me shpenzime shtesë të materialeve shpenzuese si kalkulatorë dhe materiale tjera shtesë, mesatarisht 10.68 euro për semestër. Si shpenzim shtesë në këtë fakultet është theksuar mbajtja shtesë e kurseve me qëllim zotërimin e lëndës, fenomen ky që pavarësisht efekteve pozitive në ngritjen profesionale të studentëve, hap mundësinë për parregullsi tjera.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve të Fakultetit Ekonomik udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Ky lloj i shpenzimit për aq sa lidhet me afërsinë ndërmjet lokacioneve prej nga udhëtohet për në fakultet nuk përbën problem, marrë parasysh edhe lehtësimet për studentë në bileta të udhëtimit. Mesatarisht, studentët e Fakultetit Ekonomik shpenzojnë 4.55 euro në javë për udhëtime.

Sa i përket ushqimit, dy studentë nga Fakulteti Ekonomik ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, mesatarisht 5.22 euro në ditë. Sipas studentëve, mensa nuk e mbulon ditën e diele dhe orari i servimit të ushqimit nganjëherë mund të interferojë me orarin e ligjëratave.

Dy studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me një mesatare prej 73.33 euro në muaj. Studentët e këtij fakultetit të akomoduar në konvikt kanë pasur ankesat e tyre rreth kushteve të akomodimit, të tilla si qa-

sje e kufizuar në ujë, infrastruktura e brendshme etj. Gjithashtu ata theksuan se konvikti nr.1 ku janë të vendosur kryesisht studentët e Fakultetit Ekonomik është ndër konviktet më të dobëta sa i përket kushteve të akomodimit, e për këtë arsye disa studentë deklaruan se edhe po t'i ofrohej akomodim në konvikt nuk do e pranonin.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, rreth 17.09 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarisht, studentët e Fakultetit Ekonomik shpenzojnë 130.9 euro në muaj. Këto shuma zakonisht janë përcaktuar nga rroga vetanake ose nga shuma që iu jepet atyre nga familja në muaj.

Shpenzimet e studimeve kryesisht mbulohen nga familja, me përjashtim të një studenti që punon dhe shpenzon 80% të rrogës në muaj. Studentët e tjerë kanë raportuar që janë munduar që t'i sigurojnë personalisht të ardhurat përmes të punuarit me orar të plotë u është bërë pengesë puna përgjatë studimeve.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	101.25	170	131.33
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	14.56%	6.68%	9.67%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Pr-ishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	200	90	82.5	121.3
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	6.67%	12.42%	11.76%	8.43%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	133.4	125
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	9.48%	11.02%

Fakulteti Juridik

Në fokus grupin e Fakultetit Juridik kanë marrë pjesë 16 studentë, 12 nga të cilët janë femra, dhe 4 janë meshkuj. Tre studentë janë në vitin e parë, gjashtë në vitin e dytë, katër në vitin e tretë, dhe tre në vitin e katërt. Katër studentë banojnë me qira në Prishtinë, katër studentë udhëtojnë çdo ditë për në Prishtinë, dy banojnë në konvikte, dhe gjashtë janë banorë të përhershëm të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të Fakultetit Juridik është 20.3 (viti i parë 19.6, viti i dytë 19.3, viti i tretë 20.75, dhe viti i katërt 22.3).

Përveç studentëve të vitit të parë që janë të liruar nga pagesa e semestrit, dy studentë të vitit të tretë ishin po ashtu të liruar nga semestri për shkak të kategorive që i përkasin. Dy studentë paguajnë 125 euro semestrin.[9] Studentët e tjerë paguajnë 25 euro për semestër.

Studentët e Fakultetit Juridik shpenzojnë mesatarisht 43.9 euro në semestër për literaturë. Parregullsitë të cilat lidhen me literaturën dhe formave alternative të sigurimit të literaturës janë të shprehura edhe në këtë fakultet. Studentët e vitit të katërt obligohen që të blejnë libra që arrijnë vlerën e 40 eurove; disa profesorë nga kjo njësi akademike nuk pranojnë në ligjëratat e tyre studentë të cilët nuk e kanë librin e kërkuar nga profesori i lëndës; profesor që riboton librin e tij çdo vit dhe studentët e rinj detyrohen ta blejnë çdo vit versionin e "përditësuar" të librit; profesorë që obligojnë studentët të blejnë libër i cili nuk u shërben atyre si material për marrjen e njohurive nga ajo lëndë; si dhe profesorë që përsërisin testet vlerësuese të lëndëve respektive që nga viti 2004.

Përveç literaturës së nevojshme për studime, studentët gjithashtu kanë shpenzime të materialeve të tjera të nevojshme për studime, me një mesatare prej 49 eurosh për semestër. Materialet shtesë që implikojnë shpenzime shtesë lidhen kryesisht me mungesën e infrastrukturës brenda fakultetit dhe pamundësinë për të korresponduar me profesorë përmes emailave e që më pas studentët obligohen të shkojnë fizikisht në kabinetet e tyre.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj. Studentëve të kësaj njësie akademike u është premtuar nga menaxhmenti se në qoftë se transkripta e notave u duhet për praktika që lidhen me universitetin, studentët do të lirohen nga kjo pagesë por që nuk është realizuar ende ky premtim.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Mesatarisht, studentët e Fakultetit Juridik shpenzojnë rreth 9.6 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, tre studentë nga Fakulteti Juridik ushqehen në mensën

9 Studime me korrespondencë.

e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me një mesatare prej 4.5 eurosh në ditë.

Dy studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj, njëri prej tyre është i liruar nga pagesa e konvikteve. Katër të tjerë banojnë me qira, ku mesatarja e qirasë arrin 107.5 euro në muaj.

Studentët kanë pretenduar për disa parregullsi në konvikte, si: studentë të nivelit master të pranuar në konvikte përmes nepotizmit, studentë të cilët nuk plotësojnë kriterin e largësisë gjeografike etj. Disa studentë që kanë qenë të akomoduar në konvikte gjatë vitit të parë, kanë kaluar në banesë me qira në vitin e dytë për shkak të kushteve të këqija në konvikte.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, dalje natën, shëtitje, kinema, video lojëra, etj., me një mesatare prej 20.8 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarja e shpenzimeve totale në muaj arrin 126.25 euro. Këto shuma zakonisht janë përcaktuar nga rroga vetanake ose nga shuma që iu jepet atyre nga familja në muaj.

Studentët kanë raportuar që sigurimi i të ardhurave në mënyrë vetanake të ndikon në arritshmëri përgjatë studimeve, sepse punëdhënësit nuk ofrojnë orare fleksibile për vijueshmërinë në fakultet. Disa studentë kanë raportuar që detyrohen të paguajnë avokatë deri në 350 euro me qëllim kryerjen e praktikës që do ua mundësonte ngritjen profesionale paralelisht me kryerjen e fakultetit.

Shpenzimet e studimeve kryesisht mbulohen nga familja, me përjashtim të një studenti që punon.

Gjithashtu, studentët e Fakultetit Juridik janë ankuar për diskriminimin e Ministrisë së Arsimit në ndarjen e bursave, ku studentët e kësaj njësie akademike janë të përjashtuar nga kjo bursë.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit				
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**	**Viti i katërt**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	148.3	88.3	153.75	143.3
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	18.35%	11.66%	31.33%	14.62%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	243.75	63.75	115	93.3
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	30.28%	16.36%	14.17%	13.26%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	120.42	143.75
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	19.12%	19.18%

Fakulteti i Edukimit

Në fokus grupin e Fakultetit të Edukimit kanë marrë pjesë 13 studentë, të gjitha femra. Katër studentë janë në vitin e parë, katër në vitin e dytë, dhe pesë në vitin e tretë. Tre studentë banojnë me qira, katër studentë udhëtojnë çdo ditë, katër banojnë në konvikte, dhe dy janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të Fakultetit të Edukimit është 19.9 (viti i parë 19.3, viti i dytë 19, dhe viti i tretë 20.8).

Përveç studentëve të vitit të parë që janë të liruar nga pagesa e semestrit, dhe një studente në vitin e dytë po ashtu e liruar nga pagesa, të gjithë studentët e tjerë paguajnë 25 euro për semestër.

Shpenzimet për literaturë në këtë fakultet arrijnë shumën prej 24.3 euro për semestër, mesatarisht. Literaturën të cilën obligohen ta blejnë për disa lëndë të caktuara studentët e Fakultetit të Edukimit, nuk u shërben si material për përgatitje për provimet e lëndëve respektive. Disa nga librat nuk iu lejohet t'i kopjojnë. Një profesor në këtë fakultet ka mbajtur evidencë për blerjen e librit nga ana e studentëve.

Shpenzime tjera shtesë të obligueshme marrë parasysh natyrën e këtij fakulteti, përfshinë materialet e shumta për punime seminarike dhe prezantime dhe praktikat që duhet t'i kryejnë studentët e Fakultetit të Edukimit në shkolla fillore, të mesme të ulëta apo të lartë varësisht nga programi i studimeve, shpenzimet e kryerjes së këtyre praktikave detyrohen t'i mbulojnë vetë studentët. Këto shpenzime janë mesatarisht 11.9 euro për semestër.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Mesatarisht, studentët e Fakultetit të Edukimit shpenzojnë 7.3 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, dy studentë nga Fakulteti i Edukimit ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 5.3 euro në ditë. Sipas studentëve që ushqehen në mensë, ushqimi nuk është aq kualitativ.

Katër studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, ku qiraja është mesatarisht 115 euro në muaj.

Kushtet e akomodimin në konviktin nr.3 ku janë të vendosur studentë të këtij fakulteti jo edhe aq të mira, ankesa kryesore: mungesa e ujit.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, ushqim, dhe aktivitete sportive, që mesatarisht kushtojnë 20.75 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpen-

zime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarisht, studentët shpenzojnë 134.23 euro në muaj. Këto shuma zakonisht janë përcaktuar nga rroga vetanake ose nga shuma që iu jepet atyre nga familja në muaj.

Shpenzimet e studimeve kryesisht mbulohen nga familja, me përjashtim të një studenti që punon dhe shpenzon 85% të rrogës në muaj. Sipas studentëve të këtij fakulteti, në të shumtën e rasteve është e vështirë për familjen që t'i përballojnë shpenzimet e studimeve për fëmijët e tyre.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	130	142.5	131
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	7.71%	21.75%	25.14%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	216.67	87.5	113.75	145
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	25.56%	12.86%	29.33%	12%

Fakulteti Filozofik

Në fokus grupin e Fakultetit Filozofik kanë marrë pjesë 14 studentë, 9 nga të cilët janë femra, dhe 5 janë meshkuj. Pesë studentë janë në vitin e parë, pesë në vitin e dytë, dhe katër në vitin e tretë. Tre studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, pesë banojnë në konvikte, dhe tre janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të Fakultetit Filozofik është 19.8 (viti i parë 18.2, viti i dytë 20.4, dhe viti i tretë 21.25).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit, përveç një studenti me shtetësi të huaj. Një student i vitit të tretë është i liruar nga pagesa. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Shpenzimet mesatare për literaturë për këtë fakultet janë 24.46 euro për semestër. Lidhur me shpenzimet për literaturë disa studentë kanë deklaruar se ka raste kur obligohen t'i blejnë 3 deri në 4 libra për lëndë. Studentët gjithashtu nuk mund të kopjojnë librin ose ta ekspozojnë librin e kopjuar para profesorit gjatë ligjëratave.

Shpenzime të materialeve shpenzuese të përfshira si: punime seminarike, prezantime, hulumtime dhe anketa mbulohen nga vetë studentët. Këto shpenzime arrijnë mesatarisht 17.5 euro në semestër.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Studentët që udhëtojnë çdo ditë kanë pohuar se është e lodhshme për ta. Mesatarisht studentët e Fakultetit Filozofik shpenzojnë 6.25 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, pesë studentë nga Fakulteti Filozofik ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Një student është i liruar nga pagesa. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 7.96 euro në ditë. Të ushqyerit në mensë nga studentë të këtij fakulteti konstatohet të jetë jo edhe aq mënyre kualitative e të ushqyerit, marrë parasysh papastërtinë, pritjen në radhë etj.

Pesë studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Një student është i liruar nga pagesa. Tre të tjerë banojnë me qira, me mesatarisht 61.67 euro në muaj. Pagesë shtesë që është përfshirë në akomodimin në konvikt ka qenë edhe pagesa për internet (1 euro) por është ndaluar për shkak të internetit të dobët.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, dalje natën, video lojëra, dhe kinema. Këto shpenzime janë mesatarisht 11.96 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Studentët e Fakultetit Filozofik shpenzojnë mesatarisht 128.57 euro në muaj. Këto shuma zakonisht janë përcaktuar nga rroga vetanake ose nga shuma që iu jepet atyre nga familja në muaj.

Shpenzimet e studimeve kryesisht mbu-

lohen nga familja, me përjashtim të pesë studentëve që punojnë. Disa studentë kanë pohuar që të punuarit gjatë studimeve ka penguar arritjet në fakultet, ndërsa disa të tjerë nuk janë pajtuar që puna të pengon në studime.

Përfituesit e bursës universitare kanë konsideruar që shuma e bursës së përfituar është e pamjaftueshme për nëntë muajt aktiv të studimeve dhe se Filozofiku nuk ka qasje në bursën e MASHT-it.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	147	124	111.3
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	17.23%	31.81%	11.13%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	176.7	110	94	156.7
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	43.33%	9.2%	21.04%	8.65%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	111.1	160
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	14.71%	33.76%

Fakulteti i Mjekësisë

Në fokus grupin e Fakultetit të Mjekësisë kanë marrë pjesë 18 studentë, 8 nga të cilët janë femra, dhe 10 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, katër në vitin e dytë, dy në vitin e tretë, dy në vitin e katërt, katër në vitin e pestë, dhe dy në vitin e gjashtë. Pesë studentë banojnë me qira, katër studentë udhëtojnë çdo ditë, katër banojnë në konvikte, dhe pesë janë banorë të përhershëm të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të Fakultetit të Mjekësisë është 21.11 (viti i parë 18.3, viti i dytë 19.8, viti i tretë 21, viti i katërt 23.5, viti i pestë 23.3, dhe viti i gjashtë 23).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Një student i vitit të gjashtë është i liruar nga pagesa. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Shpenzimet mesatare për literaturë në këtë fakultet arrijnë shumën prej 88 euro për semestër, ndër fakultet me më shumë shpenzime për literaturë. Shpenzimet e shumta për literaturë janë parë si shqetësim nga ana e studentëve, duke filluar nga Atlasi Anatomik i cili kushton nga 80-100 euro, e më pas edhe libra të tjerë përgjatë studimeve. Një profesor nga ky fakultet ka lënë listë të evidencës në librari/fotokopje për t'i evidentuar studentët të cilët ia kanë blerë librin e tij.

Materialet shpenzuese si: mantele, veshje adekuate, kapuça, dorëza që u nevojiten studentëve përgjatë studimeve janë parë nga disa si shpenzim i panevojshëm, ngase sipas tyre do duhej të ua siguronte vetë fakulteti këto materiale, e për disa të tjerë ky lloj i shpenzimit nuk përbënte edhe aq problem. Materialet shpenzuese për semestër arrijnë shumën prej 47.2 euro mesatarisht.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Studentët nga kjo njësi akademike kanë theksuar se shumica e tyre jetojnë në Prishtinë për shkak të angazhimeve të shumta dhe se është pothuajse e pamundur të udhëtohet në baza ditore për shkak të këtyre angazhimeve në fakultet. Mesatarisht, studentët e këtij fakulteti shpenzojnë 11.98 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, pesë studentë nga Fakulteti i Mjekësisë ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, mesatarisht 5.11 euro në ditë. Të ushqyerit ne mensë e justifikon plotësisht çmimin e paguar për ushqimin që servon mensa e studentëve, sipas studentëve të Fakultetit të Mjekësisë.

Katër studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Sa i përket kushteve të akomodimit në konvikte, studentë raportuan që kushtet e konvikteve janë të tmerrshme dhe po-

thuajse hapësira të pabanueshme. Pesë studentë banojnë me qira, mesatarisht 78.75 euro në muaj. Për shkak të lokacionit ku ndodhet Fakulteti i Mjekësisë, studentët që banojnë në banesa private detyrohen të marrin banesa në lagjet përreth fakultetit që sipas tyre qiraja në të shumtën e rasteve është e shtrenjtë.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, dalje natën, video lojëra, sport dhe kinema. Këto shpenzime arrijnë shumën prej 22.88 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarisht këto shpenzime janë 184.72 euro në muaj. Këto shuma zakonisht janë përcaktuar nga rroga vetanake ose nga shuma që iu jepet atyre nga familja në muaj.

Shpenzimet e studimeve kryesisht mbulohen nga familja, me përjashtim të katër studentëve që punojnë. Të siguruarit e të ardhurave në mënyrë vetanake përmes punës është pothuajse e pamundur për shkak të angazhimeve të shumta në fakultet, vetëm në rastet kur punohet punë sezonale, e që megjithatë nuk mjaftojnë për t'i financuar komplet studimet.

Studentët e Fakultetit të Mjekësisë kanë deklaruar se kanë qasje në tri bursa: universitare, komunale dhe të MASHT-it dhe se vetëm bursa universitare nuk u mjafton për mbulimin e shpenzimeve të studimit.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit						
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**	**Viti i katërt**	**Viti i pestë**	**Viti i gjashtë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	106.3	187.5	95	290	213.8	262.5
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	10.56%	22.01%	13.67%	27.86%	17.32%	24.43%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Pr-ishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	236	206.3	170	128
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	22.75%	18.00%	21.14%	12.23%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	176.8	191
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	17.34%	19.28%

Fakulteti i Arteve

Në fokus grupin e Fakultetit të Arteve kanë marrë pjesë 14 studentë, 11 nga të cilët janë femra, dhe 3 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, katër në vitin e dytë, katër në vitin e tretë, dhe dy në vitin e katërt. Tre studentë banojnë me qira, katër studentë udhëtojnë çdo ditë, katër banojnë në konvikte, dhe tre janë banorë të përhershëm Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të Fakultetit të Arteve është 19.8 (viti i parë 19.25, viti i dytë 19.25, viti i tretë 20.75, dhe viti i katërt 21.5).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit, përveç një studente. Dy studentë të vitit të tretë janë të liruar nga pagesa. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Studentët e Fakulteti të Arteve të cilët kanë marrë pjesë në këtë hulumtim pohuan se në të shumtën e rasteve nuk janë të obliguar të blejnë librat në origjinal, me përjashtim të një rasti ku profesori i lëndës ua kërkon librin ku është vetë autor. Kjo sepse edhe vlerësimi në atë lëndë duke i vlerësuar njohuritë të marra vetëm nga ai libër. Shpenzimet për literaturë arrijnë shumën prej 43 eurosh mesatarisht për semestër.

Marrë parasysh departamentet dhe natyrën e këtij fakulteti, studentët deklaruan se materialet shpenzuese kanë kosto të lartë për xhepin e tyre, të tilla si: blerja dhe mirëmbajtja e instrumenteve, pëlhura, ngjyra, brusha, në artin pamor etj. Studentët pjesëmarrës në fokus grup shprehën shqetësimin e tyre rreth pamundësisë që vetë fakulteti të ua sigurojë këto materiale shpenzuese. Këto shpenzime arrijnë shumën prej 133.21 euro mesatarisht për semestër.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Mesatarisht, studentët e këtij fakulteti shpenzojnë 14.8 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, tre studentë nga Fakulteti i Arteve ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 5 euro në ditë. Respondentët kanë deklaruar që në mensë, marrë parasysh pagesën edhe ushqimi që servohet është në rregull.

Katër studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me mesatarisht 86 euro në muaj. Studentët që banojnë në konvikte kanë deklaruar që kushtet nuk janë të mira.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, dalje natën, kinema, teatër dhe koncerte. Këto shpenzime janë mesatarisht 20 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për

shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarisht, studentët e Fakultetit të Arteve shpenzojnë 177.14 euro në muaj. Këto shuma zakonisht janë përcaktuar nga rroga vetanake ose nga shuma që iu jepet atyre nga familja në muaj. Disa nga respondentët deklaruan se punojnë vetë për t'i mbuluar shpenzimet përgjatë studimeve, ndonëse kjo përbën problem në arritshmëri në studime.

Të ardhurat mbështetëse përmes bursës nuk mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve në studime.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit				
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**	**Viti i katërt**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	181.25	193.75	170	150
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	27.64%	24.07%	23.39%	19.05%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	228.3	187.5	117.5	191.7
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	26.11%	27.19%	24.87%	15.28%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	184.091	151.667
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	25.69%	17.09%

Fakulteti i Filologjisë

Në fokus grupin e Fakultetit të Filologjisë kanë marrë pjesë 12 studentë, 10 nga të cilët janë femra, dhe 2 janë meshkuj. Tre studentë janë në vitin e parë, pesë në vitin e dytë, dhe katër në vitin e tretë. Katër studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, tre banojnë në konvikte, dhe dy janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të Fakultetit të Filologjisë është 19.8 (viti i parë 18.6, viti i dytë 19.6, dhe viti i tretë 21).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Një student i vitit të dytë dhe një i vitit të tretë janë të liruar nga pagesa. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Sigurimi i literaturës përmes formave alternative nuk paraqet problem në këtë njësi akademike, madje disa profesorë ua sigurojnë studentëve literaturën në formatin PDF, kanë deklaruar respondentët e fokus grupit të Fakultetit të Filologjisë. Mesatarisht ata shpenzojnë 36 euro për semestër në literaturë.

Materialet shpenzuese më të shpeshta i përbëjnë: fletoret, punimet seminarike etj., po ashtu praktikat e ndryshme që duhet t'i kryejnë studentë të këtij fakulteti. Mesatarisht ata shpenzojnë 19.25 euro për materiale shpenzuese për semestër.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Studentët që udhëtojnë kanë theksuar se për ta është humbje kohe rrugëtimi për në fakultet dhe anasjelltas. Mesatarisht ata shpenzojnë 12.5 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, dy studentë nga Fakulteti i Filologjisë ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Një student është i liruar nga pagesa. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 4.8 euro në ditë. Orari i të ushqyerit në mensë është problematik sepse shpesh herë bie ndesh me kohën e ushtrimeve dhe ligjëratave.

Tre studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Katër të tjerë banojnë me qira, me mesatarisht 68.75 euro në muaj. Sa i përket akomodimit në konvikte, pjesëmarrësit në fokus grup patën ankesat e tyre lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së studentëve në konvikte.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, dalje natën, video lojëra, teatër, kinema dhe koncerte. Mesatarisht studentët e Filologjisë shpenzojnë 19.67 euro në javë për rekreacion.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarisht studentët e Filologjisë shpenzojnë 187.1 euro në muaj. Këto shuma zakonisht janë përcaktuar nga rroga vetanake ose nga shuma që iu jepet atyre nga familja në muaj.

Studentët që një shumë të të ardhurave e kanë siguruar vet përmes të punuari me gjysmë orari kanë konsideruar se puna nuk iu ka penguar përgjatë studimeve, madje studentët e departamentit të gazetarisë theksuan se puna që disa prej tyre bëjnë në këtë fushë më shumë u shërben për ngritje profesionale sesa për të ardhurat që ua siguron kjo punë.

Bursa universitare sipas pjesëmarrësve në fokus grup, është e pamjaftueshme, po ashtu marrë parasysh faktin se studentët e kësaj njësie akademike nuk kanë qasje në bursën që ofron MASHT-i.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	208.33	174	187.5
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	32.25%	41.43%	23.33%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	237.5	140	158.3	200
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	39.29%	15%	42.96%	14.64%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	177.5	235
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	31.02%	42.86%

Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore (FShMN)

Në fokus grupin e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore kanë marrë pjesë 12 studentë, 9 nga të cilët janë femra, dhe 3 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, katër në vitin e dytë, dhe katër në vitin e tretë. Tre studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, tre banojnë në konvikte, dhe tre janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të FShMN është 19.8 (viti i parë 18, viti i dytë 20.5, dhe viti i tretë 21).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Profesorët e kësaj njësie akademike shpesh herë i kërkojnë librat në origjinal dhe se disa janë vetë autorë të këtyre librave kanë deklaruar studentët pjesëmarrës në fokus grupin e Shkencave Matematike-Natyrore. Mesatarisht studentët e FShMN shpenzojnë 32.08 euro në semestër për literaturë.

Materialet shpenzuese nuk janë të shumta përveç fletave të bardha për ushtrime dhe studentët e departamentit të shkencave kompjuterike të cilët duhet t'i sigurojnë laptopët për studimet në këtë departament. Këto shpenzime arrijnë mesatarisht 22 euro për semestër.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Studentët e FShMN shpenzojnë mesatarisht 8.16 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, tre studentë nga FSHMN ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 4.4 euro në ditë. Rreth kualitetit të ushqimit në mensë kishte mospajtime mes studentëve që ushqehen ose janë ushqyer aty.

Tre studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me mesatarisht 122.66 euro në muaj. Kushtet në konvikt sipas studentëve banues të kësaj njësie akademike janë të mira në përgjithësi.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, dalje natën, video lojëra, teatër, kinema dhe hiking. Mesatarisht këto shpenzime arrijnë 14.5 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarisht shpenzimet totale mujore janë 181 euro në muaj. Të gjithë studentë financohen nga familja e tyre. Disa studentë theksuan se ndjejnë presion nga familja për kryerjen e fakultetit në kohë

dhe presionin për gjetjen e punës menjëherë pas përfundimit të fakultetit.

Studentët thonë që bursa universitare është e pamjaftueshme; disa departamente brenda këtij fakulteti kanë kriter më të ulët të notës mesatare për përfitimin e bursës.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	166.6	170	205
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	11.11%	38.33%	16.00%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	223.33	156.6	183.33	155
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	36.00%	16.67%	19.29%	24.05%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	176.25	196.6
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	25.62%	24.83%

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Në fokus grupin e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës kanë marrë pjesë 13 studentë, 6 nga të cilët janë femra, dhe 7 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, tre në vitin e dytë, katër në vitin e tretë, dhe dy në vitin e katërt. Tre studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, tre banojnë në konvikte, dhe katër janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të FNA është 19.7 (viti i parë 18, viti i dytë 20, viti i tretë 20.5, dhe viti i katërt 21.5).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër. Studentët e vitit të katërt paguajnë 150 euro për semestër.

Studentët e departamentit të Arkitekturës kanë studime të integruara (3+2), që nënkupton bachelor dhe master. Ata kanë kushtëzime nëse duan t'i ndërpresin studimet posa e përfundojnë nivelin bachelor duke mos e vazhduar nivelin master në të njëjtin institucion (UP). Kushtëzimi ka të bëjë me një nënshkrim që duhet dhënë për të deklaruar se studenti vullnetshëm heq dorë nga vazhdimi i nivelit master dhe posa e bën këtë nuk ka të drejtë të vazhdoj masterin më në këtë institucion.

Shpenzimet për literaturë arrijnë mesatarisht 49 euro për semestër. Literatura sigurohet kryesisht përmes skriptave që në të shumtën e rasteve i përgatisin vetë studentët, e që këto skripta përmbajnë shumë gabime pastaj. Burim tjetër i sigurimit të literaturës është edhe interneti, kanë deklaruar studentët pjesëmarrës në fokus grup.

Edhe në këtë fakultet ka profesorë që i obligojnë studentët t'i blejnë librat e tyre, si dhe një libër obligativ në një lëndë është në gjuhën serbe.

Materialet shpenzuese si laptop, programe të ndryshme softuerike (vlen të ceket se programet e nevojshme softuerike nuk ofrohen nga fakulteti, si lëndë e veçantë e që megjithatë studenti obligohet t'i dijë këto programe), punimet të ndryshme që mund të mbërrijnë vlerën e 100 eurove, çanta të posaçme, vizore, hamera, stilolapsa adekuat e kështu me radhë. Mesatarisht, për një semestër, studentët e FNA-së shpenzojnë 122.15 në materiale shtesë.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, paraqitja e provimeve në master, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Mesatarisht studentët e FNA-së shpenzojnë 8.36 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, pesë studentë nga FNA ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 4.15 euro në ditë. Në mensë servimi i ushqimit gjatë ramazanit shtyhet për iftar; ose mundesh me u shërby më herët mirëpo nuk është ushqimi i njëjtë si ai

që servohet gjatë kohës së iftarit, kanë deklaruar studentët e FNA-së.

Tre studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me 73.33 euro mesatarisht në muaj. Konvikti nr.5 ku janë të akomoduar djemtë nga ky fakultet është në gjendje të rëndë sipas tyre.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, futboll, video lojëra, shëtitje, kinema dhe biliardo. Mesatarisht këto shpenzime janë 14.25 në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Studentët e FNA-së shpenzojnë mesatarisht 200 euro në muaj. Të gjithë studentë financohen nga familja e tyre. Për shkak të angazhimeve të shumta në fakultet është e pamundur të punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë.

Bursa universitare nuk jepet për vitin e tretë të studimeve. Për vitet tjera kriteri i notës mesatare është 8.0.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit				
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**	**Viti i katërt**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	206.25	311.67	136.25	150
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	24.38%	31.17%	16.00%	15.07%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	321.6	200	205	106.25
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	26.91%	30.56%	18.50%	13.43%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	125.8	264.2
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	14.96%	27.41%

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Në fokus grupin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë kanë marrë pjesë 13 studentë, 8 nga të cilët janë femra, dhe 5 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, pesë në vitin e dytë, dhe katër në vitin e tretë. Tre studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, tre banojnë në konvikte, dhe katër janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të FBV është 20.15 (viti i parë 18.25, viti i dytë 20.6, dhe viti i tretë 21.5).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Studentët e FBV shpenzojnë mesatarisht 25.38 në semestër për literaturë. Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë po ashtu janë evidentuar raste kur profesorët kërkojnë nga studentët të ia blejnë librin e tyre, madje duke i joshur ata përmes favorizimeve të ndryshme siç është shpërblimi me pikë shtesë në provim kanë thënë respondentët nga ky fakultet.

Materiale shpenzuese si xhama për mikroskop, mantele për brenda fakultetit dhe në terren, çizme, stetoskop, që të gjitha duhet t'i mbulojnë vetë studentët. Këto shpenzime arrijnë 45 euro në semestër mesatarisht.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Mesatarisht studentët e FBV shpenzojnë 7.11 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, tre studentë nga FBV ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me 3.8 euro mesatarisht në ditë. Të ushqyerit në mensë përbën problem për studentë të kësaj njësie akademike ngase objekti i fakultetit gjendet larg objektit të mensës, rrjedhimisht bëhet e pamundur qasja në mensë.

Tre studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me 76.25 euro mesatarisht në muaj.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në sport, kafe, shëtitje, kinema, teatër, shopping, udhëtime. Këto shpenzime janë mesatarisht 15.26 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Studentët e FBV shpenzojnë mesatarisht 142.76 euro në muaj. Një student vet-financohet, tre të tjerë punojnë por financohen edhe nga familja, ndërkohë që të tjerët financohen vetëm nga familja.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	110	79.2	255
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	17.53%	15.09%	30.83%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	173.33	98.66	156.66	142.5
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	17.50%	9.5%	20.80%	16.67%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	117	184
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	16.05%	23.73%

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Në fokus grupin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike kanë marrë pjesë 12 studentë, 4 nga të cilët janë femra, dhe 8 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, pesë në vitin e dytë, dhe katër në vitin e tretë. Tre studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, tre banojnë në konvikte, dhe tre janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të FIM është 20 (viti i parë 18.75, viti i dytë 21, dhe viti i tretë 20.5).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Për dallim nga njësitë tjera akademike, qasja në literaturë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike është më e lehtë, ngase një pjesë e literaturës është e ngarkuar në sistemin elektronik të studentëve (SEMS). Megjithatë, edhe parregullsitë nuk mungojnë.

Një libër obligativ i një lëndë blihet në kabinetin e profesorit dhe kushton 10 euro, një lëndë tjetër ka 5 libra të cilat duhet blerë dhe kushtojnë rreth 20 euro, dhe libra të tjerë shtesë që nevojiten për ushtrime, gjithnjë sipas studentëve që kanë marrë pjesë në hulumtim.

Mesatarisht 35.20 euro shpenzohen në semestër për literaturë në këtë fakultet.

Materiale shpenzuese që lidhen me pajisje sipas natyrës së këtij fakulteti disa sigurohen nga fakulteti e disa pajisje tjera duhet blerë vetë studentët, zakonisht letra të bardha, vizore, stilolapsa, ndërsa pjesët për ushtrime mekanike i posedon fakulteti. Këto shpenzime arrijnë 52.27 euro mesatarisht për semestër.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Mesatarisht studentët e FIM shpenzojnë 13.14 euro në javë për udhëtim.

Sa i përket ushqimit, tre studentë nga FIM ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 6.66 euro në ditë. Marrë parasysh çmimin kushtet e mensës dhe konvikteve janë relativisht të mira sipas studentëve të këtij fakulteti të cilët banojnë në konvikte dhe ushqehen në mensë.

Tre studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me qira mesatare prej 58.33 euro në muaj.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në shëtitje, kafe, kinema, dalje, futboll. Mesatarisht këto shpenzime janë 21.25 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Me-

satarisht një student i FIM shpenzon 166.66 euro në muaj. Një student vet-financohet, ndërkohë që të tjerët financohen vetëm nga familja. Puna për aq kohë sa është me orar të plotë përbën pengesë përgjatë studimeve, andaj burimet e të ardhurave janë kryesisht nga familja dhe nganjëherë punë sezonale.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	173.75	115	211.25
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	12.54%	24.45%	13.73%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	206.66	113.33	190	156.66
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	13.27%	18.84%	24.26%	10.38%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	102.5	198.75
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	16.52%	18.42%

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Në fokus grupin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike kanë marrë pjesë 14 studentë, 10 nga të cilët janë femra, dhe 4 janë meshkuj. Pesë studentë janë në vitin e parë, katër në vitin e dytë, dhe pesë në vitin e tretë. Tre studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, pesë banojnë në konvikte, dhe tre janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të FIEK është 20.21 (viti i parë 18.8, viti i dytë 20.25, dhe viti i tretë 21.6).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Një student i vitit të tretë është i liruar nga pagesa, të tjerët paguajnë 25 euro për semestër.

Mesatarisht, studentët e FIEK shpenzojnë 25.71 euro në semestër për literaturë. Pjesëmarrësit në fokus grupin e FIEK-ut kanë thënë se literatura nga studentët e kësaj njësie akademike kryesisht sigurohet nga librat e fotokopjuar dhe skriptat të ndryshëm. Edhe në këtë fakultet ka profesorë që shesin librin e tyre në kabinet dhe mbajnë evidencë për studentët që e kanë blerë librin.

Mesatarisht, studentët e FIEK shpenzojnë 51.65 euro në semestër për materiale shtesë. Mikroprocesorë, module për ushtrime, kalkulatorë, fleta të bardha për ushtrime, kurse shtesë për zotërimin e lëndës edhe pse këtë të fundit nuk je i detyruar, porse lënda kalohet më lehtë nëse ndjek kurset shtesë për lëndë të caktuara.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Studentët e FIEK shpenzojnë mesatarisht 5.98 euro në javë në udhëtim.

Sa i përket ushqimit, shtatë studentë nga FIEK ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Kjo shifër përbën numrin më të madh të studentëve brenda një njësie akademike, pjesëmarrës në fokus grup, që ushqehen në mensë (50% e pjesëmarrësve në fokus grup). Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 2.8 euro në ditë. Marrë parasysh çmimin kushtet e mensës janë relativisht të mira sipas studentëve të këtij fakulteti.

Pesë studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me mesatarisht 75 euro pagesë për qira në muaj. Studentët e FIEK kanë ankesa për kushtet e konvikteve. Amfiteatri i konvikteve pengon të mësuarit në bibliotekat e konvikteve, pastaj ka standarde të dyfishta të trajtimit të studentëve në konviktet për vajza dhe djem.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, sport, dalje, kinema, futboll, video lojëra, teatër, hiking, snacks, udhëtime. Mesatarisht, këto shpenzime arrijnë 8.23 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për shpenzimet e tyre totale mujore. Studentët e FIEK shpenzojnë mesatarisht 109 euro në muaj. Disa studentë punojnë, ndërkohë që të tjerët financohen vetëm nga familja. Disa studentë nga ky fakultet kanë kryer praktika që lidhen me fakultetin dhe se janë paguar për këto praktika, kjo ua ka mundësuar sigurimin e një pjesë të të ardhurave për t'i financuar studimet e tyre.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit			
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	73.75	105	142
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	5.78%	13.27%	15.13%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	123.33	56.66	120	135
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	21.54%	5.92%	13.51%	12.53%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	114.44	98.75
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	12.60%	10.05%

Fakulteti i Shkencave Sportive

Në fokus grupin e Fakultetit të Shkencave Sportive kanë marrë pjesë 14 studentë, 3 nga të cilët janë femra, dhe 11 janë meshkuj. Katër studentë janë në vitin e parë, katër në vitin e dytë, tre në vitin e tretë, dhe tre në vitin e katërt. Tre studentë banojnë me qira, tre studentë udhëtojnë çdo ditë, gjashtë banojnë në konvikte, dhe dy janë banorë të Prishtinës.

Mosha mesatare e studentëve të FShS është 20.29 (viti i parë 19, viti i dytë 20, viti i tretë 20.7, dhe viti i katërt 22).

Studentët e vitit të parë janë të liruar nga pagesa e semestrit. Një student i vitit të dytë është i liruar nga pagesa, të tjerët paguajnë 25 euro për semestër. Edhe pse pagesa për semestër është shumë simbolike, sipas studentëve pjesëmarrës në fokus grupin e Fakultetit të Shkencave Sportive, studentët e dalluar duhet liruar nga kjo pagesë.

Literatura nga studentët e kësaj njësie akademike sigurohet kryesisht përmes kopjeve, studentët nuk janë të detyruar të blejnë literaturën origjinale dhe se disa libra i posedon biblioteka e fakultetit me ç'rast studentët mund t'i shfrytëzojnë ato. Mesatarisht, studentët e FShS shpenzojnë 19 euro për semestër në literaturë.

Marrë parasysh disiplinat e shumta që përbëjnë lëndë të veçanta në këtë fakultet, studentët kanë shpenzime shtesë që lidhen me sigurimin e pajisjeve të ndryshme sportive të tilla si: rroba të veçanta për disiplina (shembull: futboll, karate, not etj.) Pastaj aplikimi i sporteve në praktikë përmes shfrytëzimit të pishinave, ambienteve të ndryshme sportive (palestra, pista të atletikës), terrene për skijim etj. Edhe pse zakonisht kur këto aktivitet organizohen nga fakulteti ka lehtësime në pagesa për studentë. Këto shpenzime arrijnë 105 euro në semestër, mesatarisht.

Përveç pagesës së semestrit si pagesë administrative përgjatë studimeve, studentët gjithashtu kanë pagesa të tjera administrative si ID, transkripta e notave, etj. Pagesat administrative shtesë do duhej të përfshiheshin në shumë që paguhet për semestër, sipas studentëve të FShS.

Të gjitha kategoritë e studentëve udhëtojnë në një mënyrë ose tjetër; disa udhëtojnë çdo ditë nga vendbanimet e tyre për në Prishtinë, disa udhëtojnë një herë në javë për në vendbanimet e tyre, si dhe studentët banorë të Prishtinës përdorin Trafikun Urban ose taksi për nevoja të studimeve. Studentët e FShS shpenzojnë mesatarisht 9.07 euro në javë në udhëtim.

Sa i përket ushqimit, pesë studentë nga FShS ushqehen në mensën e Qendrës së Studentëve, me pagesë prej 15 eurosh në muaj. Të tjerët ushqehen në mënyrë vetanake, me mesatarisht 5.15 euro në ditë. Sasia e ushqimit që servohet në mensë nuk është e mjaftueshme dhe se duhet ngrënë jashtë mensës për t'i plotësuar racionet ditore të ushqimit, sipas studentëve.

Gjashtë studentë banojnë në konvikte, me pagesë prej 20 eurosh në muaj. Tre të tjerë banojnë me qira, me 75 euro në muaj mesatarisht.

Përveç ushqimit dhe pagesave të tjera për nevojat e studimeve, studentët gjithashtu shpenzojnë në rekreacion, kryesisht në kafe, sport, dalje, kinema, futboll, video lojëra, teatër, hiking, snacks, udhëtime. Këto shpenzime janë mesatarisht 15.25 euro në javë.

Duke konsideruar të gjitha këto shpenzime, studentët janë përgjigjur për

shpenzimet e tyre totale mujore. Mesatarisht, studentët e FShS shpenzojnë 173 euro në muaj. Disa studentë punojnë, ndërkohë që të tjerët financohen vetëm nga familja. Disa studentë të këtij fakulteti punojnë përgjatë studimeve për t'i siguruar të ardhurat, kryesisht në palestra sportive dhe punë që lidhen me natyrën e fakultetit të tyre.

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Shpenzimet totale mujore sipas viteve të studimit				
Vitet e studimit	**Viti i parë**	**Viti i dytë**	**Viti i tretë**	**Viti i katërt**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	162.5	222.5	175	120
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	11.17%	31.92%	12.23%	13.33%

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS KATEGORIVE

Shpenzimet totale mujore sipas kategorive				
Kategoritë	**Banon me qira në Prishtinë**	**Udhëton çdo ditë për Prishtinë**	**Konvikte**	**Banor i përhershëm i Prishtinës**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	**251.66**	**148.33**	**136**	**185**
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare	**22.26%**	**25.78%**	**21.21%**	**6.75%**

TË DHËNA TË VEÇANTA SIPAS GJINISË

Shpenzimet totale mujore sipas gjinisë		
Gjinia	**Femër**	**Mashkull**
Mesatarja e shpenzimeve mujore	140	179
Mesatarja e proporcionit të shpenzimeve me të ardhurat familjare		19.90%

Përfundime

Probleme e shpenzime të shumta përcjellin studimet e studentëve të Universitetit të Prishtinës. Mungesa e literaturës, detyrimi i studentëve për blerje të literaturës specifike, kushtet e dobëta të konvikteve të vjetra, etj. Gjithashtu, është shqetësuese kualiteti i ushqimit që studentët e konsumojnë gjatë ditës në mënyrë vetanake (4.7 euro në ditë për tre shujta).

Të vetmet njësi akademike, sipas respondentëve, në të cilat profesorët nuk detyrojnë studentët të blejnë literaturë origjinale, ose të profesorëve të lëndës, janë Fakulteti i Filologjisë dhe Fakulteti i Shkencave Sportive. Madje, në këto njësi akademike janë raportuar edhe lehtësime, si: ofrimi i librit në formatin PDF nga profesori, ose libra të qasshëm në bibliotekën e fakultetit etj.

Më poshtë mund të gjeni krahasime të secilit shpenzim, me fakultetin që ka më shumë shpenzime dhe atë që ka më pak.

Sa i përket literaturës, studentët e Fakultetit të Mjekësisë shpenzojnë më së shumti (87.9 euro për semestër), ndërkohë që studentët e Fakultetit të Shkencave Sportive shpenzojnë më së paku (19.07 euro për semestër).

Sa i përket materialeve shpenzuese, studentët e Fakultetit të Arteve shpenzojnë më së shumti (133.2 euro për semestër), ndërkohë që studentët e Fakultetit Ekonomik shpenzojnë më së paku (10.68 euro për semestër).

Sa i përket pagesave administrative, studentët e Fakultetit Filozofik shpenzojnë më së shumti (6.25 euro për semestër), ndërkohë që studentët e Fakultetit Juridik shpenzojnë më së paku (1.56 euro për semestër).

Sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, studentët e Fakultetit të Arteve shpenzojnë më së shumti (14.8 euro në javë), ndërkohë që studentët e Fakultetit Ekonomik shpenzojnë më së paku (4.55 euro në javë).

Sa i përket shpenzimeve të ushqimit, studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike shpenzojnë më së shumti (6.66 euro në ditë), ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike shpenzojnë më së paku (2.81 euro në ditë).

Sa i përket qirasë, studentët e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore shpenzojnë më së shumti (122 euro në muaj), ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike shpenzojnë më së paku (58.33 euro në muaj).

Sa i përket shpenzimeve për rekreacion, studentët e Fakultetit të Mjekësisë shpenzojnë më së shumti (22.88 euro në javë), ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike shpenzojnë më së paku (8.23 euro në javë).

Sa i përket shpenzimeve totale mujore, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës shpenzojnë më së shumti (200.38 euro në muaj), ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike shpenzojnë më së paku (109.61 euro në muaj).

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

KITU
KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE TRANSPARENCË NË UNIVERSITET

KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo